

Vendim nr. 178 datë 18.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 18.07.2023 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 10 (Sh) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: **SHOQËRIA “AYEN AS ENERGY” SH.A.**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i ligjit nr. 98/2022, datë 22.12.2022 “Për krijimin e kontributit të solidaritetit gjatë kohëzgjatjes së periudhës së krizës energjetike”, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 11, 15, 16, 17, 18, 41, 131, pika 1, shkronjat “a” dhe “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 9590, datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare”; nenet 27 e vijues, 47, 50, 51, 71 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 22.12.2022, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin nr. 98/2022 “Për krijimin e kontributit të solidaritetit gjatë kohëzgjatjes së periudhës së krizës energjetike” (*ligji nr. 98/2022*), me objekt vendosjen e rregullave të përkohshme për krijimin e kontributit të solidaritetit gjatë kohës së krizës energjetike, me qëllim rishpërndarjen e të ardhurave shtesë për paketat sociale (*neni 1*). Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 8, datë 18.01.2023 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në këtë fletore.

2. Qëllimi i ligjit është marrja e masave të jashtëzakonshme dhe të kufizuara në kohë për të përballuar krizën energjetike dhe për të mbrojtur konsumatorët, veçanërisht shtresat në nevojë, nga ndikimet e rritjes së çmimeve nga lufta Rusi-Ukrainë, duke garantuar njëkohësisht ruajtjen e qëndrueshmërisë së financave publike (*neni 2*). Ai zbatohet për të gjithë prodhuesit e energjisë elektrike, rezidentë tatimorë në Republikën e Shqipërisë, të cilët e tregtojnë këtë produkt me çmime të liberalizuara, ndërkohë që nuk zbatohet për prodhuesit e energjisë elektrike ndaj të cilëve është vendosur detyrimi i shërbimit publik në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ose që kanë kontratë shitblerjeje energjie elektrike me operatorë publikë. Sipas nenit 5 të këtij ligji, të ardhurat shtesë të krijuara nga prodhuesit e energjisë elektrike i nënshtrohen një kontributi solidariteti të përkohshëm të detyrueshëm (*pika 1*), i cili llogaritet mbi të ardhurat shtesë të krijuara në vitin fiskal nga shitja në treg të lirë e energjisë elektrike të prodhuar me çmim më të lartë se 8.5 lekë/kWh (*pika 2*). Norma e zbatueshme për llogaritjen e kontributit të solidaritetit është në masën 50% të bazës së referuar në pikën 2 të këtij neni (*pika 3*). Kontributi i solidaritetit derdhet në një llogari të veçantë të buxhetit të shtetit dhe përdoret në mënyrë transparente për paketat sociale në ndihmë të qytetarëve (*pika 4*).

3. Po sipas këtij ligji, masa e kontributit të solidaritetit për vitin paraardhës përlllogaritet nga prodhuesi i energjisë duke filluar nga viti 2023, duke kryer veprimet e mëposhtme në rend kronologjik: a) llogaritet çmimi mesatar i ponderuar me sasi të respektive të shitjeve të energjisë elektrike gjatë vitit paraardhës; b) llogaritet sasia e energjisë elektrike e shitur me çmime të liberalizuara gjatë vitit paraardhës; c) llogariten të ardhurat shtesë të vitit paraardhës, duke zbritur çmimin mesatar të ponderuar të shitjes së energjisë nga çmimi 8.5 lekë/kWh dhe shumëzuar me sasinë e shitur gjatë vitit paraardhës; ç) llogaritet kontributi i solidaritetit duke shumëzuar të ardhurat shtesë të vitit paraardhës me normën 50% (*neni 6*). Prodhuesi i energjisë elektrike, brenda datës 31 janar të çdo viti, llogarit kontributin e solidaritetit dhe e vetëdeklaron atë në administratën tatimore. Pagesa e këtij kontributi bëhet në 2 kështe të barabarta, ku kësti i parë i shumës së përgjithshme të kontributit të solidaritetit të vitit paraardhës paguhet deri më 31 mars dhe kësti i dytë paguhet deri më 30 nëntor (*neni 7*).

Mospagimi në afat i kontributit sanksionohet me gjobë në masën 10% të shumës së kështit për t'u paguar, deri në bllokim të llogarive bankare dhe, nëse pas verifikimit administrata tatimore konstaton se prodhuesi i energjisë transferon të ardhurat duke aplikuar çmime dukshëm më të ulëta sesa çmimi i tregut, i lind e drejta të bëjë rivlerësimin e përlllogaritjes së kontributit të solidaritetit (*neni 8, pikat 2 dhe 3*).

4. Subjektet që i nënshtrohen këtij ligji kanë detyrimin për zbatimin e legjislacionit tatimor në fuqi, ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat” në lidhje me deklarimin dhe pagesën e tatimit mbi fitimin korporativ, sipas dispozitave dhe afateve të atij ligji. Kontributi i jashtëzakonshëm, që paguhet sipas dispozitave të këtij ligji, përbën shpenzim të zbritshëm në kuptim të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat” (*neni 9*). Ligji është zbatueshëm nëse në vitin përkatës çmimi mesatar i shitjes së energjisë në bursën hungareze është mbi 180 euro/MWh dhe, në çdo rast, e humb efektin e tij më datë 31 dhjetor 2024 (*neni 10*).

5. Në zbatim të këtij ligji, në datën 22.02.2023, përmes shkresës nr. 10 prot., drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (*DPT*) kërkuesja ka kryer vetëdeklarimin e masës së kontributit të solidaritetit, si dhe ka kundërshtuar bazën ligjore dhe kushtetuese të ligjit nr. 98/2022, duke arsyetuar se kundërshtimet dhe argumentet e dhëna prej saj gjatë fazave të para të hartimit të projektligjit nuk janë marrë parasysh. Me shkresën nr. 1752, datë 27.02.2023 të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor (*DKT*) pranë Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj (*DTM*) në DPT, është lëshuar autorizim për verifikimin në vend nga inspektorët të llogaritjes, deklarimit dhe derdhjes në buxhet nga kërkuesja të kontributit të solidaritetit për vitin 2022. Akti i konstatimit i përpiluar nga inspektorët i është njoftuar kërkueses me shkresën nr. 1752/1, datë 28.03.2023. Sipas këtij akti, kontributi i solidaritetit i kërkueses për vitin 2022 është përlllogaritur në shumën 3,529,880,845 lekë. Po kështu, me shkresën nr. 1881 prot., datë 06.03.2023, kërkuesja është njoftuar nga DKT-ja se, bazuar në dispozitat e ligjit, brenda afatit 31.03.2023 duhet të paguajë në një bankë të nivelit të dytë kështin e parë të shumës së përgjithshme të kontributit të solidaritetit, si dhe për sanksionin në masën 10% të shumës së kështit për t'u paguar ose bllokimin e llogarive bankare në rast të mospagimit në afat të kësteve të kontributit.

6. Në datën 02.06.2023 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin si antikushtetues të ligjit nr. 98/2022, duke pretenduar se ligji cenon të drejta kushtetuese.

II

Pretendimet e kërkueses

7. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se ligji nr. 98/2022 cenon:

7.1. *Lirinë e veprimtarisë ekonomike në lidhje me të drejtën për pronë private*, për shkak të ndërhyrjes në mënyrë arbitrare, përmes krijimit të kontributit të solidaritetit, si një taksim i jashtëzakonshëm, duke caktuar kritere përlllogaritëse abuzive dhe me efekt prapaveprues. Natyra tejet rënduese e këtij kontributi mbi veprimtarinë ekonomike konsiderohet shpronësim *de facto* i së drejtës së pronës private, të garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, duke çuar në shkatërrim të biznesit të subjekteve që i nënshtrohen këtij ligji.

7.2. *Parimin e proporcionalitetit*, pasi:

7.2.1. Përcaktimi i subjekteve që i nënshtrohen zbatimit të ligjit është bazuar në kritere joobjektive, pa një analizë racionale të kritereve përcaktuese, përmes zbatimit të një metodologjie të pambështetur në studime në vendosjen e çmimit referencë për shitjet, duke përfshirë pjesën më të madhe të operatorëve të energjisë elektrike, si dhe operatorët e tregut të prodhimit dhe shitjes së llojeve të tjera të energjisë. Zëvendësimi i vullnetit të subjektit ekonomik me atë të legjislatorit pa pasur një justifikim objektiv ose të bazuar në kritere logjike e ekonomike të përcaktimit të komponentëve të kostos së një produkti, duke përcaktuar një çmim fiks për të gjithë operatorët në treg, mbi kufirin e të cilit çdo e ardhur do të konsiderohet “e ardhur shtesë”, përbën cenim flagrant të lirisë së veprimtarisë ekonomike. Kriteri i përlllogaritjes së “të ardhurave shtesë” nuk gjen analogji në ligje të ngjashme të vendeve fqinje ose të Bashkimit Evropian dhe është i ndryshëm nga mënyra e përlllogaritjes së këtyre të ardhurave në rregulloren e Këshillit të BE-së 2022/1854. Përcaktimi si e ardhur shtesë i shitjes së energjisë mbi çmimin 8.5 lekë/kWh zbatohet në mënyrë statike dhe të padiferencuar kundrejt të gjithë operatorëve në treg, pa bërë dallime sipas veçorive të çdo subjekti, ndërsa kontributi i solidaritetit në vlerën 50% të të gjitha të ardhurave të tregtimit të energjisë elektrike vendos një detyrim joproporcional që dëmton rëndë veprimtarinë ekonomike të subjekteve. Po kështu, krahas detyrimit për pagesën e kontributit të solidaritetit, ligji parashikon edhe detyrimin për pagesën e tatimit mbi fitimin, duke i taksuar dyfish subjektet. Sanksionet që ai vendos në rast të mospagimit të kontributit janë shumë të rënda.

7.3. *Parimet e shtetit të së drejtës dhe të sigurisë juridike*, pasi, në kundërshtim me nenin 155 të Kushtetutës, ligji zbatohet me efekt prapaveprues *in pejus*, duke shtrirë efektet në një periudhë tatimore të mbyllur. Ligji ka hyrë në fuqi në shkurt të vitit 2023, ndërkohë që përlllogaritja e kontributit të solidaritetit bëhet mbi

bazën e veprimeve të kryera në vitin 2022, kur legjislacioni në fuqi parashikonte pagesën e detyrimeve tatimore. Ndonëse ligjvënësi ka përdorur termin “kontribut i solidaritetit”, natyra e vërtetë e tij është ajo e një tatimi. Dispozitat ligjore janë të paqarta, kontradiktore dhe të parealizueshme, në cenim të parimit të sigurisë juridike.

- 7.4. *Parimin e barazisë përpara ligjit*, pasi ligji trajton në mënyrë të diferencuar subjektet që preken prej tij në raport me subjektet e tjera prodhuese të energjisë elektrike ose subjektet e tjera që operojnë në tregun e ngjashëm të prodhimit dhe tregtimit të gazit dhe produkteve të hidrokarbureve, të cilët u nënshtrohen rregullave të zakonshme të përlllogaritjes së tatimit mbi fitimin dhe janë përjashtuar nga zbatimi i dispozitave të ligjit nr. 98/2022. Kështu, ligji përcakton një trajtim të diferencuar të subjekteve që tregtojnë energjinë elektrike me çmime të liberalizuara nga ato subjekte, brenda kësaj kategorie, që kanë detyrimin e shërbimit publik ose që kanë kontratë shitblerjeje energjie elektrike me operatorët publikë, pa përcaktuar bazat objektive të këtij trajtimi të diferencuar. Ligji diskriminon në mënyrë të pajustificuar edhe në përcaktimin e çmimit dysHEME për tregtimin e energjisë elektrike dhe për përlllogaritjen e të ardhurave shtesë, duke barazuar situata objektivisht të ndryshme, pa asnjë shkak ose justifikim objektiv. Trajtimi i njëjtë i dy kategorive të ndryshme operatorësh, siç janë ata që operojnë në treg të rregulluar dhe ata në treg të parregulluar, përmes përcaktimit të një çmimi të njëjtë dysHEME për tregtimin e energjisë elektrike, mbi të cilin do të përlllogaritet kontributi i solidaritetit, pa marrë parasysh karakteristikat e ndryshme të strukturës së tregut, përbën diskriminim të paarsyeshëm dhe të pajustificuar. Ekzistenca e një kontrate shitblerjeje energjie me operatorët ekonomikë publikë nuk përbën kriter të arsyeshëm për trajtimin e diferencuar të subjekteve që ndodhen në të njëjtat kushte, siç është tregtimi i energjisë me çmime të liberalizuara. Përcaktimi i çmimit dysHEME në vlerën 8.5 lekë/kWh bie ndesh me vendimin nr. 27, datë 16.02.2023 të Entit Rregullator të Energjisë, i cili ka përcaktuar çmimin e blerjes së energjisë në vlerën 10 lekë/kWh. Ky trajtim i diferencuar konsiston edhe në taksimin dy herë të subjekteve të ligjit për të njëjtat të ardhura, si përmes pagesës së kontributit, ashtu edhe përmes pagesës së tatimit mbi të ardhurat.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkuases

8. Çështja e legjitimit (locus standi) të subjekteve që vënë në lëvizje Gjykatën është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e këtyre të drejtave.

9. Kjo dispozitë kushtetuese është zbërthyer konkretisht në ligjin nr. 8577/2000, që i njeh individit të drejtën për të ushtruar ankim kushtetues individual për kundërshtimin e çdo akti që cenon të drejtat dhe liritë kushtetuese (neni 71), si dhe parashikon kriteret paraprake që duhet të përmbushen për paraqitjen e tij (neni 71/a). Sipas pikës 2 të nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, objekt i ankimit kushtetues individual, në raste të veçanta, mund të jetë edhe ligji ose akti normativ, nëse përmbushen kriteret e parashikuara nga neni 49, pika 3, shkronja “e”, i tij, të cilat lidhen me cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të të drejtave dhe lirive kushtetuese, shterimin e të gjitha mjeteve juridike përkatëse dhe zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të aktit objekt ankimi, që do të thotë se për zbatimin e tij nuk është i nevojshëm miratimi i akteve nënligjore

10. Gjykata ka theksuar se kur objekt i ankimit kushtetues individual është një ligj ose një akt normativ, kërkuesi legjitimohet nëse plotësohen bashkërisht këto kriteret: provon se është bartës i së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar (*ratione personae*); ka shteruar mjetet juridike efektive për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar të cenuar ose provon se akti i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm; ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit (*ratione temporis*); provon interesin në lidhje me çështjen, pra cenimin e drejtpërdrejtë dhe real të së drejtës kushtetuese (*ratione materiae*) (shih vendimet nr. 12, datë 24.05.2022; nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 31, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese).

11. Kriteret e lartpërmendura për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, pra duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

12. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuësja është shoqëri aksionare, e krijuar dhe e regjistruar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt të veprimtarisë së saj financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajtjen e hidrocentraleve “Peshqesh”, “Ura e Fanit” dhe “Fangu”, si dhe transferimin e tyre nga koncensionari tek autoriteti kontraktues në përfundim të kontratës koncensionare. Në zbatim të kësaj kontrate,

objekt i veprimtarisë së saj janë edhe prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë elektrike. Në kërkesën drejtuar Gjykatës kërkesja ka kërkuar shfuqizimin e ligjit nr. 98/2022, i cili ka përcaktuar detyrimin për pagesën e kontributit të solidaritetit nga të gjithë prodhuesit e energjisë elektrike, rezidentë tatimorë në Republikën e Shqipërisë, që tregtojnë këtë produkt me çmime të liberalizuara, ku përfshihet edhe ajo. Për rrjedhojë, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, Kolegji vlerëson se si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, kërkesja legjitimohet *ratione personae* për kërkimet sipas objektit të kërkesës, pasi ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Një tjetër kriter paraprak, që duhet të përmbushet nga kërkesja përpara se t’i drejtohet Gjykatës, lidhet me shterimin e mjeteve juridike efektive, që përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000. Ky rregull nënkupton që kërkesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkesi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (shih vendimet nr. 2, datë 17.02.2022; nr. 15, datë 11.03.2021; nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese).

14. Për sa i përket përmbushjes së këtij kriteri, kërkesja ka pretenduar se ligji i kundërshtuar është drejtpërdrejt i zbatueshëm dhe nuk parashikon nxjerrjen e akteve nënligjore për zbatimin e tij. Sipas saj, përmbushja e detyrimit për të përlllogaritur dhe paguar kontributin e solidaritetit duhet të kryhet nga subjektet pa pritur nxjerrjen e ndonjë akti administrativ nga administrata tatimore, për rrjedhojë detyrimi për shterimin e mjeteve juridike bëhet i pazbatueshëm. Po sipas kërkeses, çdo mjet tjetër ankimi do të ishte inefektiv, për shkak të kohëzgjatjes së gjykimeve në shkallët e juridiksionit gjyqësor të zakonshëm, ndërkohë që sipas nenit 10 të tij, ligji i humbet efektet në datën 31.12.2024. Për të njëjtin shkak, edhe ushtrimi i ankimit kundër akteve individuale që eventualisht mund të nxirrte administrata tatimore do të ishte i paefektshëm, pasi ligji i ankimuar nuk do të ishte më në fuqi.

15. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se, si rregull, ligji zbatohet përmes akteve të organeve publike ose vendimeve gjyqësore, prandaj individit duhet, së pari, t’i kundërshtojë ato në gjykatat kompetente, duke shteruar të gjitha mjetet juridike që parashikon sistemi ynë juridik (shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 12, datë 24.05.2022; nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese). Në rastin konkret, Kolegji vëren se ndonëse ligji nuk ka parashikuar nxjerrjen e akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij ose të drejtën e

subjekteve të prekura për të kundërshtuar gjyqësisht masën e detyrimit të kontributit të solidaritetit që duhet paguar, kërkesja nuk ka asnjë pengesë që të kundërshtojë gjyqësisht një kontribut të tillë. Ashtu siç dhe rezulton nga ankimi kushtetues individual, krahas vetëdeklarimit në datën 22.02.2023 të masës së kontributit të solidaritetit në zbatim të ligjit nr. 98/2022, kërkesja ka ngritur pretendime edhe në drejtim të vendosjes së detyrimit ligjor për pagesën e këtij kontributi. Kontributi i përlllogaritur prej saj përmes vetëdeklarimit është verifikuar në vijim nga inspektorët e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor të DPT-së dhe akti i konstatimit i përpiluar prej tyre i është njoftuar me shkresën nr. 1752/1, datë 28.03.2023. Në këtë kuptim, Kolegji çmon se kërkesja nuk ka asnjë pengesë të kundërshtojë në gjykatat e zakonshme si masën e kontributit të përlllogaritur prej saj në zbatim të detyrimit ligjor, ashtu edhe aktin e nxjerrë nga DKT-ja.

16. Po kështu, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuësës se çdo mjet tjetër ankimi ndaj ligjit nr. 98/2022 nuk do të ishte efektiv, është i pabazuar, pasi vlerësimi *a priori* i saj për mungesën e efektivitetit të vendimmarrjes së gjykatave administrative përbën një prezumim të pabazuar në ligj ose fakte. Ekzistenca e dyshimeve të pambështetura për efektivitetin e një mjeti nuk përbën arsye të vlefshme për mosshkrimin e tij. Për më tepër, nëse gjykatat administrative gjykojnë se ligji mund të ketë probleme kushtetutshmërie, edhe me kërkesë të palëve, mund të investojnë Gjykatën me anë të gjykimit incidental. Nga ana tjetër, gjykatat e juridiksionit administrativ kanë mundësi të zgjidhin dyshimet interpretuese, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim pajtues që përputhet me parimet kushtetuese.

17. Në ankimin kushtetues individual kërkesja ka parashtruar si argument për inefektivitetin e gjykatave të zakonshme edhe tejzgjatjen e gjykimeve në këto gjykata, duke pretenduar, në thelb, moszgjidhjen e çështjes prej tyre brenda afatit kohor që shtrin efektet ligji i kundërshtuar. Kolegji çmon se një pretendim i tillë është hipotetik dhe i pambështetur në prova dhe ligj. Krahas faktit se neni 399/2, pika 1, shkronja “a”, i Kodit të Procedurës Civile ka parashikuar afatin 1-vjeçar për përfundimin në secilën shkallë, të gjykimit në shkallë të parë dhe në apel, pra gjatë periudhës që ligji vazhdon të prodhojë efekte, kërkesja nuk ka asnjë pengesë të kërkojë shqyrtimin e çështjes së saj me përparësi, në një afat më të shkurtër se ai i parashikuar në këtë dispozitë ligjore, nëse arrin të argumentojë përpara gjykatës së juridiksionit të zakonshëm ardhjen e pasojave të rënda ndaj veprimtarisë së saj si rrjedhojë e zbatimit të ligjit.

18. Në këndvështrim të sa më lart, Kolegji vlerëson se kërkesja nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000 përpara se t’i drejtohet Gjykatës, pasi

ajo ka ende mjete ligjore në dispozicion për të paraqitur argumentet e saj në lidhje me të drejtat që pretendon se i janë shkelur.

19. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret paraprake për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 31, dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.